

Njoftim

Pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, për llogari të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, është paraqitur për shqyrtim çështja Nr.37 Regj. Themeltar, Datë 29.08.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - KQZ.

Person i interesuar: Partia e Lirisë, përfaqësuar nga z. Altin Kaziaj.

Objekti: Shfuqizimi i vendimit nr. 179, datë 22.08.2023, të KAS “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023, të depozituar nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”.
Detyrimin e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) të marrë vendim, lidhur me kërkesën ankimore nr. 93, Dt. 20.08.2023, depozituar nga subjekti “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

Për dijeni, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, me Vendim nr.179, datë 22.08.2023 (version i shkurtuar i vendimit), objekt i kërkesëpadisë së mësipërme, ka vendosur:

“Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023, të paraqitur nga “Partia Demokratike e Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”.

Më datë **30.08.2023** u hodh shorti publik për përcaktimin e përbërjes së Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor dhe, sipas tij, trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

- 1. Marsela Dervishi (Relatore);**
- 2. Sokol Ibi (Anëtar);**
- 3. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 4. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 5. Edlira Petri (Anëtare).**

Me Urdhër datë 30.08.2023 “Për caktimin e seancës gjyqësore” të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është caktuar data **01.09.2023, ora 09:00**, për zhvillimin e seancës gjyqësore në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë.

Tiranë, më 30.08.2023

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë